



FONDI
I SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR

FOKUS

REVISTË PERIODIKE | NR. 29 | QERSHOR 2015



4 QENDRA TË REJA SHËNDETËSORE NË TIRANË



SHËRBIMI DO TË FINANCOHET NGA FSDKSH



FONDI
I SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR

KUJDESEMI PËR SHËNDETIN TUAJ!
www.fsdksh.com.al

Vlerësoni gjënë më të çmuar! **Siguroeni shëndetin**



Masa e kontributit për personat e punësuar është 3.4% e pagesës mujore (1.7% i paguan punëdhënësi dhe 1.7% i paguan punëmarrësi).

Kontributi për të vetëpunësuar në qytet është 7% e pagës minimale, ndërsa të vetëpunësuarit në fshat paguajnë 3% zonat kodrinore dhe malore dhe 5% zonat fushore.

Një mënyrë tjetër është sigurimi vullnetar. Masa e kontributit është 3.4% e pagës mujore minimale.

FOKUS

Revista "Fokus" është një botim periodik i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Synimi i këtij botimi është informacioni i të gjithë aktorëve që japin dhe marrin shërbimin shëndetësor. Mjekët do të kenë kesisoj një dritare më shumë për t'u informuar ndërsa pacientët një mundësi më tepër për të ditur të drejtat e tyre.

REVISTË PERIODIKE

NR. 29 QERSHOR 2015

NË BRENDËSI ▶

"Fokusi" përpos kontributit të stafit të Institucionit, është e hapur për përfshirjen e ideve të gjithkujt prej aktorëve ofrues të shërbimit shëndetësor, të interesuar për të dhënë kontributin e tyre.

Bordi i Revistës:

Margarit Ekonomi

Aurel Voda

Albana Adhami

Dritan Ulqinaku

Përgatiti:

Etiola KOLA

ekola@fsdksh.com.al

Tel/Fax: +355 4 2259 855

Adresa:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm
të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
Rruga "Sami Frashëri", Lagjia 8, Tiranë.

Tel: +355 4 2230 984

Fax: +355 4 2274 953

www.fsdksh.com.al



Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm
të Kujdesit Shëndetësor



FSDKSH



Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm
të Kujdesit Shëndetësor

Print & Design
Adel Co

04

SHËRBIMET ONLINE

Shëndetësia elektronike, nga vizion në realitet



09

RISIA

Shërbim shëndetësor 24 orë në zonat turistike



14

NJËSITË E LËVIZSHME

Kontrolli Mjekësor Bazë shtrihet në të gjithë Shqipërinë



21

Statistika

Cilat janë diagnozat me rimbursimin më të lartë



Shëndetësia Elektronike, nga Vizion në Realitet

Me përdorimin e teknologjisë së informacionit
ulim ndjeshëm abuzimet




Prezantohen arritjet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve shëndetësore në vend për përdorimin e platformave dhe shërbimeve të shëndetësisë elektronike. Në takim "Shëndetësia Elektronike, nga Vizion në Realitet", u prezantuan sisteme dhe platformat e reja si, sistemi i ri i recetës elektronike që nis të zbatohet për herë të parë në Durrës, sistemi i kartës së shëndetit, aplikacioni e-Barna, etj.

QËLLIMET E SISTEMEVE TË PREZANTUARA:

- Plotësimi dhe përmirësimi i shërbimit shëndetësor për qytetarët;
- Përdorimin e teknologjisë së informacionit për të patur një administrim më të mirë të burimeve financiare, njerëzore, materiale në shëndetësi dhe për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe vlerësimit të performancës të të gjithë aktorëve të sistemit shëndetësor.

RECETA ELEKTRONIKE

Sistemi më i ri në fushën e teknologjisë së informacionit në shëndetësi – është receta elektronike. Receta elektronike është në vetvete gjenerimi, transmetimi dhe plotësimi i recetave mjekësore, bazuar në infrastrukturën elektronike, duke zëvendësuar përdorimin e recetave letër. Receta elektronike e lejon mjekun të krijojë dhe të transmetojë në mënyrë elektronike një recetë si dhe farmacistin të ekzekutojë në mënyrë elektronike recetën. Ky është një projekt pilot që do të nisë në 18 Qendrat Shëndetësore të Durrësit, në 80 farmaci në sistem dhe përfitues do të jenë rreth 300 mijë banorë të Durrësit.



Sistemi e-Receta

- Gjenerimi, transmetimi dhe plotësimi i recetave mjekësore bazuar tek infrastruktura elektronike, duke zëvendësuar përdorimin e recetave letër.
- Receta elektronike e lejon mjekun, të krijojë dhe të transmetojë në mënyrë elektronike një recetë si dhe farmacistin të ekzekutojë në mënyrë elektronike recetën.
- Sistemi i e-Rx lejon FSDKSH-ne të monitorojë, kontrollojë dhe të rimbursojë recetën elektronike.
- Projekt Pilot në 18 QSH dhe 80 Farmaci në Durrës
- Projekti është bazuar në eksperiencën të suksesshme të vendeve të BE
- Realizohet vetëm për recetat me rimbursim dhe barnat nga Lista e Barnave të Rimbursuara

- Funkcionon për pacientët e pajisur me Kartë Shëndeti
- Realizohet vetëm në QSH dhe farmacitë e rrjetit të hapur që kanë kontratë me FSDKSH

Dy hallka të procesit:

Procesi e-Receta të mjeku i familjes:

Hyrja në sistem bëhet nepermjet një komunikimi të sigurtë dhe mundësohet identifikimi i çdo profesionisti të shëndetit (mjek dhe farmacist). Pas aksesimit shfaqen opsionet e gjenerimit të recetës. Për të gjeneruar një recetë, të dhënat merren fillimisht nepermjet kartës së identitetit dhe këto të dhëna identifikohen dhe nga regjistri elektronik i kartës së shëndetit. Pas identifikimit të pacientit në sistem, do të fillojë



plotesimi i recetes elektronike sipas llojit te recetes, kohes se vlefshmerise (1 apo 2 mujore); zgjidhet diagnoza e cila identifikohet sipas kodifikimit ICD9 dhe plotesohet pershkrimi me barna. Pasi hidhen te dhenat, nuk mund te kete me ndryshime ne recete. Ne kete moment pacienti behet zoterues i recetes dhe mund te kerkoje ekzekutimin e saj prane cilesdo farmaci qe ka kontrate me FSDKSH.

Procesi e-Receta ne farmaci:

Farmacia qe ka kontrate me FSDKSH hyn ne sistem permes nje komunikimi te sigurte. Ne menyre automatike shfaqet receta e plotesuar nga mjeku dhe farmacistit i jepet mundesia qe te ekzekutoje kete recete ne farmaci, te jape alternativen e listes se barnave te rimbursuara ne baze te principit aktiv qe plotesohet nga vete mjeku si dhe te plotesoje te dhenat per barin. Pas konfirmimit - nuk do te kete mundesi te ndryshohet me receta. Pas ketij hapi, kjo eshte nje recete qe njihet nga FSDKSH per rimbursim.

Avantazhe te recetes elektronike

- Rrit saktësinë në përcaktimin e barnave duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe të kosto-efektivitetit në trajtimin e pacientëve.
- Ul mundësinë e dhënies së gabuar të barnave për pacientët dhe mundëson ndërtimin e një sistemi alert në rastet e përshkrimit jo të sakte të barit, duke u mbështetur tek udhërrefyesit dhe protokollet përkatëse të miratuara.
- Ruan historikun për sëmundjen dhe trajtimin e pacientëve, duke lehtësuar mjekun për të gjykuar trajtimin medikamentoz në vazhdimësi.
- Redukton ndjeshëm kostot administrative për receten
- Eleminon fenomenin e recetave fiktive në rimbursim. Shmang abuzimet me recetat e rimbursuara.
- Bashkevepron online me insitucionet e tjera duke

shtuar efektivitetin në manaxhimin e riskut.

- Ofron për FSDKSH në kohë reale informacion dhe raporte për barnat, recetat, mjekët dhe farmacistët për qëllime monitorimi dhe rimbursimi.
- Krijon një bazë të dhënash që mund të shërbejë për studime në fushat e ekonomisë shëndetësore, farmako ekonomisë, shëndet publik, etj.
- e-Receta përdor kanalet e komunikimit të sigurte elektronik ndërmjet mjekut, farmacistit dhe institucionit rimbursues për barna të caktuara.

Aplikacioni e-Barna

Që prej vitit 2014, FSDKSH mundëson informimin në kohë reale për barnat e listës së rimbursimit, nëpërmjet të aplikacionit e-Barna. Sot, të gjitha alternativat e barnave të listës janë transparente për çmimin, formëdozen dhe elementë të tjerë të barit. Lidhur me këtë aplikacion, z. Arjan Qoku, drejtori i Drejtorisë së Informacionit dhe Analizës Statistike në FSDKSH u shpreh se aplikacioni e-Barna ka ndryshuar krejtësisht informimin e qytetarëve lidhur me listën e barnave të rimbursueshme. "Me një zgjidhje teknologjike të thjeshtë, pa kosto, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor mundëson aplikacionin e-Barna që aksesohet nëpërmjet internetit apo edhe telefonave smartphone, falë të cilit është fare e lehtë të merret informacioni për çdo bar të listës".

Karta e shëndetit

FSDKSH prezantoi edhe sistemin "Karta e Shëndetit". "Prej 6 muajsh, që me nisjen e shpërndarjes së kartës së shëndetit, janë lëshuar rreth 200 mijë karta në rang vendi. Qëllimi i saj është përmirësimi i situatës shëndetësore nëpërmjet dixhitalizimit të shërbimit dhe eliminimit të burokracisë. Kjo kartë ka lehtësuar radhët e gjata të qytetarëve në pikat e shpërndarjes së librezave, ka lehtësuar ngarkesën burokratike të mjekëve, duke rritur kohën që i shërbehet qytetarit", u shpreh znj. Amarilda Orizaj, specialiste në FSDKSH.


Portali e-Albania, portë unike për shërbimet elektronike

FSDKSH do të ofrojë në këtë portal shërbimin e prenotimit online të kartës së shëndetit

Në rrugën e transformimit dhe krijimit të kushteve të reja për qytetarët në marrëdhënie me shtetin, FSDKSH po orientohet drejt teknologjisë së informacionit, për të ofruar një shërbim më transparent, më të shpejtë dhe sigurisht më cilësor për qytetarët.

Portali qeveritar e-Albania, është një portë unike në internet, ku qytetarët, bizneset dhe vetë nëpunësit qeveritarë, mund të përftojnë shërbime elektronike. FSDKSH do të jetë pjesë e këtij portali me një shërbim të ri. Do të krijojmë mundësinë –fillimisht punonjësve të administratës që aktualisht janë të regjistruar në këtë portal – dhe më pas do ta shtrijmë këtë shërbim në të gjithë popullatën që ka akses, të prenotojnë vizitën për t'u pajisur me kartë shëndeti dhe të dërgojnë në mënyrë elektronike dokumentat e nevojshme. Kjo nismë do të lehtësojë shërbimin për të gjithë ata që duan të pajisen me kartë shëndeti.





Portali e-Albania

Portali e-Albania është një projekt i Qeverisë shqiptare, mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë, i cili transformon shërbimet në mënyrë rrënjësore duke bërë që sot 134 institucione që japin shërbime, prej të cilave 56% janë shërbime në sportele, të kthehet në një shërbim të cilësisë më të lartë dhe në një model që do të shërbejë edhe për shumë zhvillime të tjera që vijnë si rezultat i këtij transformimi.

Ne kemi tanimë më shumë se 100 shërbime të dixhitalizuara përmes portalit e-Albania, të cilin e gjetëm me 5, 6 shërbime dhe me një akses zero të qytetarëve. Sot janë mbi 100. Pjesa e mbetur, që parashikohet të jetë rreth 300 shërbime nga 390 e ca që ka sot, është pjesa më e vështirë pasi kërkon atë që thashë; sistemin bazë të të dhënave. Sot për mes portalit e-Albania është fare e thjeshtë të paguhet fatura e energjisë elektrike, fare thjeshtë të paguhet një sërë detyrimesh të tjera pa bërë absolutisht asgjë tjetër veçse një klik-u dhe dhënies aty për aty të shërbimit.

“Kjo nuk është utopi!

Kjo është e gjitha e mirëmenduar dhe e mirëorganizuar. Zgjidhja është modernizimi, modernizimi, modernizimi.”, u shpreh në prezantimin e këtij projekti Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama.

Për më shumë vizitoni: www.e-albania.al



4

qendra të reja shëndetësore në Tiranë

Për herë të parë pas 25 vitesh, Ministria e Shëndetësisë zgjeron shërbimin në Tiranën e ndryshimeve të mëdha demografike

Financimi i shërbimit do të kryhet nga FSDKSH

Angazhimi i Qeverisë për të shkuar drejt Mbulimit Universal po shoqërohet me Cilësi dhe Akses Universal, për të afruar shërbimin sa më pranë qytetarëve



Katër pika të reja shëndetësore i shtohen qytetit të Tiranës, e cila për herë të parë në 25 vite të ndryshimeve të mëdha demografike që ka pësuar kryeqyteti gjatë viteve të fundit. Pika e parë e hapur në një zonë të populluar vitet e fundit, është pika e re e zonës së "Don Boskos", e cila është një pikë e re e Qendrës Shëndetësore nr 4 në Tiranë. Kjo qendër shëndetësore i shërben 25 mijë banorëve të zonës së "Don Boskos". Qendra e re do të funksionojë sipas orareve të Kujdesit Parësor, nga ora 07:30-20:10, dhe shërbimi do të financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

"Tirana është zgjeruar shumë, ndërsa vendndodhja në territor e Qendrave Shëndetësore të Kujdesit Parësor është po ajo që ka patur para 25 vjetësh. Me këtë shqetësim, ne vendosëm që këtë vit të jemi prezent më pranë qytetarëve dhe vendbanimeve të tyre, ndaj në ditët në vijim, përpos kësaj qendre që hapim sot, do të kemi edhe 3 qendra të tjera në Tiranë – njëra do të jetë në zonën e Komunës së Parisit, një tjetër në zonën e Unazës së madhe dhe një qendër tjetër në fund të rrugës "Siri Kodra", u shpreh ministri i Shëndetësisë, z. Ilir Beqaj në inaugurimin e qendrës së re shëndetësore në zonën e "Don Boskos" në Tiranë. Z. Beqaj shprehu vendosmërinë për angazhimin e Qeverisë për të shkuar drejt Mbulimit Universal të popullatës, duke ofruar Cilësi dhe Akses universal, për ta ofruar shërbimin më pranë qytetarëve.

Kjo qendër e re është tashmë plotësisht funksionale dhe ofrontë gjithë shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. "Me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë, në një kohë rekord, u hap kjo pikë e re që mbulon të gjithë zonën e "Don Boskos" me shërbim shëndetësor Parësor. Kjo qendër e re shëndetësore do të ofrojë shërbimin e Pediatrisë, Patologjisë, Check Up, Konsultori i Fëmijës, Injeksione etj", u shpreh znj. Barie Karasani, drejtore e Qendrës Shëndetësore nr. 4.

Hapen 23 qendra të reja shëndetësore pranë zonave turistike



Financimi nga FSDKSH për barna e personel shëndetësor për të mbuluar shërbimin e pandërprerë gjatë sezonit veror

Për herë të parë, në mbështetje të gjithë atyre që në sezonin e verës do të zgjedhin t'i kalojnë pushimet përgjatë bregdetit apo në Aple janë vënë në funksion 23 qendra të reja shëndetësore, me shërbim 24 orë, me mjekë dhe infermierë. Ky funksionim 24 orë parashikohet të vijojë deri në fund të muajit gusht. Qendrat do të jenë të pajisura me një set standard mjetesh mjekësore, për t'ju përgjigjur nevojave të pushuesve për kujdes shëndetësor.

Nisur nga problematika e verejtur gjate viteve te shkuara gjate sezonit turistik, Ministria e Shendetesise dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor po mundësojnë kujdes shëndetësor të përforcuar në zonat turistike, për të qenë në këtë mënyrë më afër turistëve vendas dhe të huaj për çdo emergjencë apo problematikë shëndetësore.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor do të financojë shërbim të pandërprerë 24 orë për zonat turistike duke filluar nga ditët e para të qershorit deri më 31 gusht. FSDKSH do të financojë shpenzimet për këto qendra, të cilat do të ofrojnë shërbim të pandërprerë gjatë sezonit veror, duke filluar nga barnat, materialet mjekësore, personel mjekësor (2 mjekte dhe 2 infermiere) që do të kontraktohen për këtë periudhë në qendrat shëndetësore që ndodhen pranë lokaliteteve turistike. Këto qendra do të kenë mjekë dhe infermiere për shërbim të pandërprerë.



Fondi që do të akordohet është 60,5 milion lekë që do të përdoren për barna dhe materiale mjekësore, ambjentet dhe personelin mjekësor për këto qendra shëndetësore.

Ndërkohë Fondi po shikon mundësinë e financimit të shërbimit të pandërprerë përtej këtij afati, pas kërkesave të bëra gjatë vizites së ministrit të Shendetesise dhe drejtorit të Fondit në disa qendra shëndetësore alpine, ku sezoni vijon përtej datës 31 gusht.

Qendrat shëndetësore që do të kenë shërbim të pandërprerë gjatë sezonit turistik janë që nga Valbona, Thethi e Razma në veri dhe 19 zona të bregdetit duke filluar që nga Velipoja deri në Ksamil, si vijon:









Qendrat e reja shëndetësore
në shërbim të pushuesve gjatë sezonit veror



- 1. Valbonë
- 2. Theth
- 3. Razëm
- 4. Velipojë
- 5. Shëngjin
- 6. Plazhi i Currilave
- 7. Plazhi Durrës

- 8. Gjiri i Lalzit
- 9. Shkëmbi i Kavajës
- 10. Plazhi Golem
- 11. Mali i Robit
- 12. Plazhi Divjakë
- 13. Plazhi Darëzes
- 14. Plazhi Zvërnec
- 15. Plazhi i Vjetër



- 16. Plazhi i Radhimës
- 17. Plazhi i Dhërmiut
- 18. Plazhi Himarë
- 19. Plazhi Qeparo
- 20. Plazhi Ksamil 1
- 21. Plazhi Ksamil 2
- 22. Plazhi Borsh
- 23. Plazhi Pogradec

Kontrolli Mjekësor Bazë mbërrin në çdo cep të vendit

QSH me pajisje moderne për Kontrollin Mjekësor Bazë. Njësi të lëvizshme në zonat e thella

377

Kabinete stabile të instaluar pranë Qendrave Shëndetësore

Për **40**


QSh në zona të vështira, do të funksionojnë Njësi lëvizëse

54160

persona kanë kryer deri tani Kontrollin Mjekësor Bazë

18874

persona



35286

persona



40-55 vjeç

28842



56-60 vjeç

12857 persona



60-65 vjeç

12461 persona

Kontrolli Mjekësor Bazë falas për grupmoshat 40-65 vjeç mbërrin në çdo cep të vendit. Qendrat shëndetësore në të gjithë vendin kanë tashmë pajisje moderne dhe ambiente të posaçme për të realizuar Kontrollin Mjekësor Bazë pa pagesë për popullatën 40-65 vjeç. Ndërsa për të gjitha zonat e thella, janë vënë në dispozicion Njësitë e Lëvizshme, që do të mundësojnë këtë kontroll në të gjithë Shqipërinë.

Për herë të pare këto Njësi u përruruar në zonën e Malësisë së Madhe, në Dedaj, të komunën Shkrel të Shkodrës.

Këto njësi të lëvizshme, sipas një kalendari të caktuar, do të mbulojnë të gjitha fshatrat që i kanë larg vendbanimet nga qendrat shëndetësore, dhe më pas të gjithë qarkun e Shkodrës dhe të gjithë Shqipërinë.

“Ne jemi angazhuar t’ua ofrojmë shërbimin shëndetësor të gjithë njerëzve të kësaj grupmoshe që jetojnë në Shqipëri,” u shpreh ministri i Shëndetësisë, duke shtuar se “ky është hapi i parë drejt mbulimit shëndetësor universal, por jemi të vetëdijshëm që nëse ua ofrojmë këtë të drejtë çdo qytetari, edhe banorëve të Shkrelit, por distanca e vendbanimit nga qendrat shëndetësore është e tillë që nuk është e afërt, na duhet të ofrojmë edhe njësitë e lëvizshme”.

Ky është dhe një hap tjetër jo vetëm drejt Aksesit Universal, por edhe drejt Cilësisë Universale, tha më tej Ministri Beqaj, “pasi siç mund të shihet, në këtë njësi të lëvizshme këtu, ofrohet çdo gjë që ofrohet në njësinë e check-up edhe në Tiranë, edhe në Shkodër”.

Ne po përpiqemi që edhe banorët këtu, të kenë mundësi ta kontrollojnë shëndetin e tyre të paktën një herë në vit dhe po përpiqemi ta spostojmë vëmendjen tek shërbimi parësor shëndetësor dhe ta spostojmë vëmendjen te shëndeti. Njerëzit që vijnë tashmë këtu nuk janë më pacientë por janë thjesht qytetarë, pasi sigurisht që shkenca dhe statistikat kanë treguar që pas moshës 40 vjeç fillojnë dhe shfaqen sëmundje, sidomos ato kardiovaskulare, të cilat nëse i zbulojmë hershëm, i trajtojmë me shumë më tepër efikasitet, u shpreh kreu i shëndetësisë në vend.

Kontrolli mjekësor bazë, rruga drejt mbulimit shëndetësor universal

PARAQITUNI pranë qendrave tuaja
shëndetësore për ta përfituar atë
PA PAGESË



SI JE?

KONTROLLO SHËNDETIN
CHECKUP PA PAGESË

Kontrolli Mjekësor Bazë është një program kombëtar, pa pagesë, i miratuar me vendim nr. 185, datë 2.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 40 - 65 vjeç”.

Ky program synon: Depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente me qëllim:

- kujdesin për shëndetin ● parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve,
 - zbulimin e hershëm të çrregullimeve, ● mjekimin në fazat e hershme,
 - përmirësimin e kulturës shëndetësore.
- FSDKSH realizon mbulimin financiar të paketës, kontrollin e performancës dhe cilësisë së ofrimit të saj.



SI FUNKSIONON KONTROLLI BAZË SHËNDETËSOR?

1



ÇDO PERSON MINDS MOSHËS 40 DHE 65 VIEÇ QË ËSHTË RESIDENTI NË SHqipëRI DËZON TË DREJTËN TË KRYEJË KONTROLL SHËNDETËSOR BAZË PA PAGESË

2



PËN TË PËRITUAR NGA KY SHËRIM, JU LAJMETROHETI NGA MIKRO I FAMILJES I GJENDËS SHËNDETËSORE TË VENOGJAMIT DHE JU PROPOZOHEN TË MUNDËSI NË TË DATA NË MIJAIN TUAJ TË LINGJES

3



PASË JENI INFORMUAR PËR DATËN, JU PROTOHET NGA PUNONJËST SHËNDETËSOR NË MËDHESET E GJENDËS SHËNDETËSORE

4



PERSONELLI I GJENDËS SHËNDETËSORE SIGUROHET QË TË JENI TË MËNIFORMUAR DHE QË PËRMBUSHINI KONTRETE PËN TË PËRITUAR KONTROLLIN SHËNDETËSOR PA PAGESË

5



ME ANË TË PYETËSORIT INFERRMIERIA PLOTËSON MODULIN E VLËRËSIMIT TË FAKTORËVE TË SVILIT TË JETËS

9



LUTITË KY PAGESË NIK. ZBATI ME SHUMË SE 2 JAVË DERI NË MARRIJEN E PËRINDRIVE

8



PËRGATITËT PËRCHJLA E SHIKUAR DHE JU NJËTOHET NË POSTE

7



GRIMDULLOHEN TË GJITHA ANALIZAT DHE PËRËGJET E TESTEVE, TË CILAT ANALIZOHEN NGA MIKRO NË GJENDËN SHËNDETËSORE

6



NË KONTROLLIN SHËNDETËSOR PA PAGESË PËRSORREN KONTROLLI I GJAKUT, EXH, ANALIZAT E PARAMETREVE BIOMARKËVE TË GLUCEMISË, KOLESTEROLIT, BILIRUBINËS, URINËS MINERALJAVE, ALBUMINURIA, SI DHE NIVELIN E STRESIT DHE DEPRESIONIT



0800 7453
Numar pa pagesë

www.sije.al



Çfarë përfshin paketa e Kontrollit Mjekësor Bazë



Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekje për faktorët e stilit të jetesës:

- ♥ Ushqyerja;
- ♥ Konsumimi i duhanit;
- ♥ Konsumimi i alkoolit;
- ♥ Niveli i stresit dhe depresionit.

Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrevave fiziologjike:

- ♥ Tensioni arterial;
- ♥ Indeksi i masës trupore;
- ♥ Aktiviteti i zemrës (EKG).

Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrevave biokimikë:

- ♥ Formula e gjakut;
- ♥ Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;
- ♥ Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;
- ♥ Glicemia;
- ♥ Feçe për gjak okult;
- ♥ Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urine, azotemi dhe kratinemi;
- ♥ Bilirubinë totale dhe direkte, transaminaza (SGPT, SGOT)

Implementimi i paketës

- Mjeku i Familjes evidenton shtetasit në regjistrin elektronik të banorëve që mbulon, me të dhënat për datëlindjen dhe adresën e saktë të vendbanimit.
- Në bashkëpunim me infermierin planifikojnë për çdo javë/muaj numrin e personave dhe grafikun e ardhjes së tyre në QSH, bazuar në muajin dhe datën e lindjes.
- Qendra shëndetësore lajmëron shtetasit për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë nëpërmjet shërbimit postar (dhe nëpërmjet alternativave të tjera në vitin e parë).

Kryerja e Kontrollit Mjekësor Bazë

Infermierja pret shtetasin në ambjentin e vizitës dhe regjistron të dhënat e përgjithshme sipas formularit përkatës.

Administron pyesorët për:

- testin e depistimit për përdorimin e duhanit dhe alkoolit
- testin e depistimit të aktivitetit fizik
- testin e ushqyerjes
- testin e depresionit dhe stresit
- Mat peshën trupore, perimetrin e belit, gjatësinë, tensionin arterial dhe aktivitetin e zemrës sipas procedurave përkatëse, duke bërë shënimet në formular.
- Administron kontenierin e IFOB dhe kontenierin për mostrën e urinës.
- Merr mostrën e gjakut me procedurat e marrjes së gjakut me vakum.

Dokumenton dhe kodon epruvetat për analiza dhe formularët për çdo person.

- Pas marrjes së rezultateve të ekzaminimeve laboratorike nga laboratorët e konçensionarit, MF analizon të dhënat e çdo moduli dhe harton përgjigjen për shtetasin.
- Në përgjigjen dërguar shtetasve pasqyrohet rezultati përfundimtar i depistimit, sipas shkallës së rrezikut në nivelet:
 - pa rrezik ose me rrezik të ulët,
 - me rrezik të moderuar,
 - apo me rrezik të lartë.
- Në të dy nivelet e para të rrezikut MPF këshillojnë dhe informon për një përmirësim të stilit të jetesës, si dhe intervalet kohore për riekzaminimet.

Në rastet e rrezikut të lartë, MF referon për konsulta apo ekzaminime të tjera.

TESTET E KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË



Personeli shëndetësor pritës në Qendrën Shëndetësore fillimisht kontrollon nëse qytetari plotëson kriteret për përfitim të Kontrollit Mjekësor Bazë. Kriteret janë: Moshë, vendbanimi, ID, etj).

Më pas regjistrohen të dhënat e përgjithshme sipas Formularit A/1, i cili përfshin të dhëna identifikuese, të dhëna të përgjithshme, pyetje të përgjithshme për stilin e jetesës, sëmundje të vetëraportuara.

Testi i parë është ai i depistimit për përdorimin e alkoolit dhe duhanit, sipas formularit përkatës. Ky test kryhet për identifikon përdorimin e këtyre substancave gjatë 3 muajve të fundit, gjatë jetës, shpeshtësinë e përdorimit dhe shqetësimet e mundshme



Depresioni është një sëmundje mendore që shoqërohet me disabilitet dhe rënie të cilësisë së jetës së personave që e vuajnë. Gjithashtu, depresioni bart barrë të rëndë sociale dhe ekonomike për shkak të disabilitetit direkt dhe indirekt që shkakton. Tashmë është i njohur gjerësisht fakti që depresioni si komorbiditet përkeqëson indekset e mortalitetit dhe morbiditetit të shumë sëmundjeve somatike.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në vitin 1999 kreu një studim për të krahasuar të gjitha sëmundjet mendore, ku doli se depresioni zinte vendin e katërt si shkak i paaftësisë shëndetësore dhe u parashikua se në vitin 2020 depresioni do të renditet i dyti pas sëmundjeve kardiake, si shkaktar i paaftësisë dhe disabilitetit.

Objektivi është të mundësojë programin e kontrollit, të zbulojë, të fusë në rrugën e trajtimit të specializuar dhe të monitorojë ecurinë e pacientëve që vuajnë nga depresioni.

Përgatitja e përgjigjes

- Të dhënat e përgjithshme dhe formularët e çdo moduli për secilin shtetas grumbullohen në një dosje të veçantë individuale për çdo shtetas.
- Mostrat për matjen e parametrave bio-kimikë, pas përgatitjes, shenjimit, kodimit vendosen në ruajtje sipas kushteve të paracaktuara derisa t'i dorëzohen punonjësit të operatorit të përzgjedhur, i cili ka detyrimin të shkojë periodikisht në çdo qendër shëndetësore për të marrë mostrat.
- Përgjigjet e analizave bio-kimike, pasi dërgohen në jo më vonë se 3 ditë nga operatori i përzgjedhur (Laboratori) për tek Qendra Shëndetësore, i bashkëlidhen dosjes individuale të çdo shtetasi.
- Mjeku analizon të dhënat e çdo moduli dhe në bazë të algoritmeve vlerëson riskun.
- Mjeku harton përgjigjen.
- Operatori i përzgjedhur dërgon përgjigjen me postë në adresë të shtetasis.



Ndjekja

- Dërgimi i përgjigjes me postë individit duke e këshilluar për ndjekjen e mëtejshme nëse do të ketë nevojë;
- Përcaktimi i detyrimit ligjor për specialistët për t'i kthyer përgjigje MF për pacientin e referuar;
- Këshillimi dhe informimi për regjistrimin me një mjek familjeje, nëse nuk është i regjistruar.

PERGJIGJE PERFUNDIMTARE

Emri mbiemri: _____ ID (Nr i kartës së identitetit): _____

QSH _____ Datë _____

REZULTATI PERFUNDIMTAR I DEPISTIMIT

Pa rrezik ose me rrezik të ulët: këshillim promocioni i shëndetit dhe stilit të shëndetshëm të jetesës

Me rrezik të moderuar: këshillim, informim dhe shëndetit dhe stilit të shëndetshëm të jetesës.
Sipas rastit dhe sipas fushës ku rreziku është i moderuar duhet përpiluar skema e ndjekjes së mëtejshme dhe intervalet kohore për ri-ekzaminimet _____

Me rrezik të LARTË për:

- Sëmundje kardio-vaskulare** - Referim tek mjeku specialist;
- Diabet** - Referim tek mjeku specialist dhe këshillim, informim, promocion shëndeti;
- Kancer kolo-rektal** - Referim tek mjeku specialist;
- Probleme të aparatit urinar** - Referim tek mjeku specialist;
- Probleme të gjakut** - Referim tek mjeku specialist;
- Depresion** - Referim tek mjeku specialist;
- Të tjera** _____

BAZUAR NË REZULTATIN PËRFUNDIMTAR, A U REFERUA SUBJEKTI TEK MJEKU SPECIALIT?


Po **Jo**

Statistika

10 DIAGNOZAT ME RIMBURSIM ME TE LARTE PER MUAJIN PRILL `15

DIAGNOZA	NR I PACIENTEVE	NR RECETAVE	RIMBURSIMI (LEKE)
Hipertension esencial	159,831	162,664	159,959,726
Diabetis melitus	45,688	46,240	147,111,949
Astma bronkiale	15,115	15,272	61,426,889
Thalasemia Major	152	153	54,846,275
Insuficienca kronike e veshkave	2,051	2,458	47,598,732
Glaukoma	10,680	10,911	40,417,417
Hepatiti viral	418	436	29,424,894
Bllokim kronik	5,720	5,788	23,414,008
Leucemia mieloide	63	63	22,052,544
Skleroza multiple	141	143	21,097,756

PESHA SPECIFIKE QE ZENE 10 DIAGNOZAT ME TE SHTRNJTA NE RIMBURSIM



Statistika

10 BARNAT ME RIMBURSIMI ME TE LARTE PER MUAJIN PRILL '15

KOD ATC	EMERTIMI KIMIK	RIMBURSIMI (LEKE)	SASIA	KOD GRUPI
V03AC03	Deferasirox 250 mg	54,772,200	33,075	V03
A10AE04	Insuline Glargine solution 100 Nj.N/ ml - 3 ml	41,818,488	28,923	A10
A10AB01	Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml	24,677,436	38,459	A10
L01XE08	Nilotinib 150 mg	21,052,080	7,200	L01
A12AA20	Calcium -3-methyl-2 oxovalerate etj	17,966,095	200,299	A12
S01EC04	Brinzolamide 10mg/ml-5ml	17,204,046	12,073	S01
A10AB05	Insuline Aspart solution 100 Nj.N/ml - 3 ml	15,546,004	14,731	A10
C08CA05	Nifedipine 10 mg	15,131,857	1,763,657	C08
C02AB01	Methyldopa 250 mg	15,063,394	1,480,744	C02
C03CA01	Furosemide 40 mg	14,661,829	1,204,296	C03

10 BARNAT ME RIMBURSIMI ME TE LARTE PER MUAJIN PRILL '15

